



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 442/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. në procedurën konkurruese “E hapur”, me objekt: “Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Veleshicë”, me nr. REF-43477-02-02-2018, me fond limit 750.000.000 lekë, zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e BOE “Be - Is” sh.p.k. & “El - Prom” sh.p.k., si dhe BOE “Alko – Impex General Construction” d.sh.h. & “Rej” sh.p.k. në procedurën konkurruese të sipërcituar.

Ankimues:

BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Berisha”, Argjinatura me nr. Pasurie 482, Çerkeze, Kamëz, Tiranë.

Autoriteti Kontraktues:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat”, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë koncensionare dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.2. BOE ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat konkurruese, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.02.2018 është publikuar në portalin elektronik të prokurimeve, procedura konkurruese “E hapur”, me objekt: “Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Veleshicë”, me nr. REF-43477-02-02-2018, me fond limit 750.000.000 lekë, zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

II.2. Në datë 09.03.2018 nga ana e autoritetit kontraktues është zhvilluar procedura e konkurruese e sipërcituar, në të cilën kanë marrë pjesë ofertuesit si më poshtë vijon:

- | | |
|---|--------------|
| 1. BOE “Alko – Impex General Construction” d.sh.h. & “Rej” sh.p.k. | Skualifikuar |
| 2. BOE “Be - Is” sh.p.k. & “El - Prom” sh.p.k. | Kualifikuar |
| 3. BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. | Skualifikuar |

II.3. BOE ankimues “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k është njoftuar për skualifikimin e tij nga autoriteti kontraktues, me anë të shkresës nr. 3257/6 prot., datë 10.04.2018, për arsyet si më poshtë vijon:

- [...]1. Anëtari i Bashkimit te Përkohshëm te Shoqërive, shoqëria “Liqeni VII” sh.a. nuk ka paraqitur Dokument qe vërteton se kapitalet/asetet e shoqërisë “Liqeni VII” sh.a. nuk janë ne duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit ne qytetin ku ka selinë e saj qendrore, sipas kriterit te kërkuar ne piken 2.1/3 “Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomik” te shtojcën nr. 9 te DSK;*
- 2. Anëtari i Bashkimit te Përkohshëm te shoqërive, shoqëria “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. nuk ka paraqitur Certificate Regjistrimi i personit te Tatueshëm NUIS.*
- 3. Shoqërisë Projektuese E.B.S. sh.p.k. i mungojnë pikat e licencës profesionale 3/c; 4/b-d; 5/e; 10/a-b;[...]*

II.4. Në datën 20.04.2018, BOE ankimues, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktues me arsyetimin si më poshtë:

[...]Nepërmjet shkresës nr. 3257/6, date 10.04.2018 me lende: Njoftim per ofertuesit e skualifikuar, nenshkruar nga Sekretari i Pergjithshem i Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, z. Gentian Keri, jemi vene ne dijeni se oferta e paraqitur prej nesh per ndertimin me koncesion te hidrocentralit Veleshice eshte skualifikuar me arsyet e meposhtme:

- 1. Anëtari i Bashkimit te Përkohshëm te shoqërive, shoqëria “Liqeni VII” sh.a. nuk ka paraqitur Dokument qe vërteton se kapitalet/asetet e shoqërisë “Liqeni VII” sh.a. nuk janë ne duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit ne qytetin ku ka selinë e saj qendrore, sipas kriterit te kërkuar ne piken 2.1/3 “Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomik” te shtojcën nr. 9 te DSK;*

2. Anëtari i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, shoqëria “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. nuk ka paraqitur Certifikate Regjistrimi të personit të Tatueshëm NUIS.

3. Shoqërisë Projektuese E.B.S. sh.p.k. i mungojnë pikat e licencës profesionale 3/c; 4/b-d; 5/e; 10/a-b;

Persa me siper, gjykojme se Komisioni i Dhenies së Koncesionit ka gabuar në këte vendimarrje, pasi Referuar pikës 1 të Njoftimit për ofertuesin e skualifikuar ku citohet se Anëtari i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, shoqëria “Liqeni VII” sh.a. nuk ka paraqitur Dokument që vërteton se kapitalët/asetet e shoqërisë “Liqeni VII” sh.a. nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit në qytetin ku ka selinë e saj qendrore, sipas kriterit të kërkuar në pikën 2.1/3 “Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomik” të shtojcën nr. 9 të DSK;

-Në hartimin e DSK është parë e arsyeshme që të nderhyet në formatin standart të “DOKUMENTAVE STANDARDE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT PËR KONTRATAT E PUNËVE CIVILE”, ku me konkretisht është hequr Shtojca 10 “Deklarate mbi gjendjen gjyqësore”, deklaratë e cila në kushte normale e bën të panevojshme Vertetimin nga Përmbarimi, por heqja e saj si duket ka bërë që ky vertetim të zëvendësojë këte deklaratë, duke fryrë artificialisht volumin e dokumentave të paraqitur në tender dhe ecejaket nëpër zyra me dokumenta të cilët janë të panevojshëm pasi qoftë për Vertetimin e Zyres Përmbarimore, qoftë për Certifikate Regjistrimi të personit të Tatueshëm NUIS, është krejtësisht e tepert paraqitja e tyre në këte procedurë kur të gjitha shoqëritë kanë paraqitur paraprakisht Ekstraktet Historike dhe Ekstraktet të Regjistrimit Tregëtar në të cilët theksojmë se nuk rezultojnë asnjë e dhënë që të insinuojë kapitalët/asetet e shoqërisë “Liqeni VII” sh.a. janë në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to. Në rast se do të ekzistonte një gjë e tillë duke ditur se në bazë të akteve ligjore dhe nenligjore Zyrat Përmbarimore urdhëjnë Q.K.B menjëherë të vendosi sekuestron dhe ky urdhër ka fuqi deri në revokim nga Përmbarimi me Akt të veçantë përmbarimor. Urdhri shpallet nga QKB në mbështetje të nenit 519; 527 të Kodit të Procedurës Civile, neni 31 pika b, neni 46 i ligjit nr. 10031 dt. 11.12.2008 “Për shërbimin Përmbarimor” të ndryshuar me ligjin nr. 10137 dt. 11.05.2009, ndryshuar me ligjin nr. 36/2012 dt. 29.03.2012. ndryshuar me ligjin 80/2013 datë 14.02.2013. Në vazhdim të procedurave ligjore në Ekstraktet e Q.K.B regjistruhen urdhrat e Zyrave Përmbarimore për sekuestrore dhe behet njoftimi i përmbaruesit online nga Q.K.B në kohë reale.

Realisht shoqëria “Liqeni VII” sh.a. e disponon një dokument të tillë dhe kjo vërtetohet me dokumentin bashkëngjitur lëshuar nga Zyra Përmbarimore Durrës me nr. 15 Prot që mban datë 27.02.2018, fakti që nuk është paraqitur është thjesht një gabim njëzëzë, që krijohet kur Autoriteti Kontraktor kërkon volum pa fund dhe të panevojshëm dokumentesh. Mungesa e këtij dokumenti nuk duhet të konsiderohet shkak për skualifikim përderisa me dokumentacionin e paraqitur të shoqërisë ka mjaftueshëm dokumenta të tjera që të verifikojë statusin aktual ligjor të shoqërisë.

-Persa i përket pikës 2 të Njoftimit për ofertuesin e skualifikuar: Anëtari i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, shoqëria “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. nuk ka paraqitur Certifikate Regjistrimi të personit të Tatueshëm NUIS. Ju bëjmë me dije se Anëtari i përkohshëm i Joint Venture shoqëria Gjelbërimi 2000 shpk ka paraqitur një dokument në format .fdp me emërtim “GJELBERIMI 3 Licensat QKL Nipti” ku sic mund të vihet re edhe nga emërtimi i dokumentit aty është edhe

Certifikate Regjistrimi i personit te Tatueshëm NUIS. Kjo eshte lehtesisht e verifikueshme pasi gjendet ne dokumentat e ruajtur ne sistem per kete procedure. Jemi shprehur edhe ne piken paraardhese per kotesine e paraqitjes se ketij dokumenti, dhe na vjen keq qe nje dokument i tille i cili nuk perben as devijim nese mund ta quajm keshtu i cili te ndryshoje thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe permbajtjen e ofertes te konsiderohet si kusht per skualifikim thjesht si arsye per diskriminim.

-Persa i perket pikes 3. Shoqërisë Projektuese E.B.S. sh.p.k. i mungojnë pikat e licencës profesionale 3/c; 4/b-d; 5/e; 10/a-b; Ju bejme me dije se per hartimin e projektit te ketij koncesioni ka patur nje pjesemarrje te dy kompanive projektuese “E.B.S” sh.p.k dhe “TAULANT” sh.p.k te cilat jane marre me pjese te ndryshme te hartimit te projektit te nevojshem per projektin e kerkuar. Pikat e paraqitura si mungese te licenses profesionale nga ana e “E.B.S” sh.p.k plotesohen nga ana e shoqerise tjeter projektuese “Taulant” sh.p.k pikat 3/c; 4/b; 10/a-b i permbush te gjitha shoqeria tjeter projektuese pra “Taulant” sh.p.k. Persa i perket pikes se licenses 4/d e cila parashikon Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacioni, e shohim te paarsyshme ne nje procedure si kjo e jona koncesion per ndertimin e HEC Veleshica.

Lidhur me ofertuesit e tjere ne kete procedure konkurrimi, perkatesisht Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “BE-IS” sh. p. k. dhe “ELPROM” sh. p. k., si dhe Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Alkolpex General Construction” degë e shoqërisë së huaj dhe “Rej” sh. p. k. jane kualifikuar padrejtesisht dhe ne kundërshtim te Dokumentave te Koncesionit, me aragumentat e meposhtme:

1. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “BE-IS” sh p. k. dhe “ELPROM” sh p. k, rezulton te mos kete permbushur keto kerkesa te Dokumentave te Koncesionit:

a. Kontrata e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive eshte nenshkruar nga persona te cilet nuk rezultojne te kene autorizimet perkatese nga organet vendimmarrese te shoqerive perkatese, dhe ne kete gjykim rezulton se Kontrata e Bashkimit te Perkohshem ne fjale, pra ajo e dorzuar per marrjen me koncesion te hidrocentralit Veleshice, eshte e pavlefshme pasi nuk shpreh vullnetin e ortakeve te shoqerive pale ne kete Kontrate. Per sa me siper, e konsiderojme absurde faktin nese Autoriteti Kontraktues do te vijonte vleresimin e metejshtme te ofertes se paraqitur nga ky Bashkim Shoqerish, dhe per me teper ta shpallte ate fitues, ne kushtet kur ortaket e ketyre shoqerive nuk jane ne dijeni, ne rastin me te mire apo dhe ne kundërshtim te vullnetit te tyre, ne rastin me te keq.

b. Nga informacionet qe disponojme, na rezulton se shoqeria “EL-PROM” sh.p.k. eshte nje shoqeri e krijuar rishtazi dhe ne kete llogjike ajo nuk mund te permbush asnje nga kriteret kualifikuese te cilesuara ne Dokumentat e Koncesionit, por dhe referuar VKM 575/2013 ne seksionin e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive. Qofte referuara elementeve konkret te marra persiper nga secili anetar, rezulton se shoqeria “EL-PROM” sh.p.k. nuk ka paraqitur asnje licence profesionale dhe/ose licence individuale per punimet elektrike qe ka marre persiper. Ne kete menyre eshte e jashteligjshme ti besohet nje punim kaq i rendesishme per objektin e koncesionit ne fjale qe eshte ajo e punimeve elektrike nje shoqerie e cila nuk provon dot keto aftesi.

c. Ne Dokumentat e Koncesionit, pikerisht ne piken 6 te pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” te shtojcës 9 te DSK, kerkohet prej secilit anetar te Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive, Diplome, Urdhër mjeku, CV, Libre të pune si dhe te jete ne listëpagesat e paraqitur nga operatori per 2 vitet e fundit, te Mjekut te shoqërisë ne zbatim te Ligjit Nr.10237 date 18/02/2010 “Per sigurinë dhe shëndetin ne pune”, i ndryshuar, neni 23 si dhe vendimin Nr.312, date 05.05.2010 “Per miratimin e

rregullores per sigurinë ne kantier”, aneksi V, VKM nr.742 date 06.I 1.200. Rezulton se shoqeria “EL PROM” sh.p.k. nuk ka paraqitur keto dokumenta dhe si rredhoje perben shkak per skualifikim e ofertuesit.

d. Gjithashtu kerkojme verifikimin e plotesimit te pikes 4 te kriterave teknike kualifikues, te pikës 2.3 “Kapaciteti teknik” te shtojcës 9 te DSK, sidomos perfshirja e stafit teknik te listuar ne kete pike ku duhet “detyrimisht te jene te pasqyruar ne listë pagesat e shoqërisë, duhet te paraqitet kontrate noteriale pune, diplome, CV dhe librezat e punës”

e. Ne oferten teknike te paraqitur nga ky ofertues, konstatohet nje fuqi e instaluar e ofertuar prej rreth 14 MË dhe prodhim te energjise vjetore ne mbi 45 milion kWh. Gjykojme se nisur nga kushti teknik i vendosur ne Dokumentat e Koncesionit nga ana e Autoritetit Kontraktues, pra ndertimi i hidrocentralit Veleshice mbi lumin Veleshice ne segmentin uhor nga kuota 834 m m.n.d deri ne kuoten 450 m m.n.d., eshte e pamundur nje fuqi dhe nje energji e tille e ofruar. Kete fakt e argumentojme, se shoqeria jone, qysh ne propozim te ketij HEC-i, e ka studiuar vazhdimisht kete lum, referuar regjimit uhor te tij por dhe bazuar dhe ne lartesine e vendosur si kusht teknik nga Autoriteti Kontraktues, madje na eshte akorduar nje kontrate nga Ministria e Energjise, kontrate e cila u anulua per shkak se Ministria mori vendimin e zgjerimit te siperfaqes se Basenit uhor, per me teper kemi konkuruar te gjitha heret qe ky koncension eshte shpallur, kemi mare edhe bonuse per kete, pra e kemi studjuar ne vazhdimesi dhe; theksojme eshte e pamundur ndertimi i hidrocentraleve ne me shume se 8 MË. Per mp teper per verifikimin e ketij fakti, ju lutemi te referoheni studimit te fizibilitetit te hartuar nga Komisioni i Dhenies me Koncesion, i cili ne baze te ligjit 125/2013 ndryshuar me ligjin nr. 88/2014 dhe ligin nr. 77/2015 per Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, Neni 15 pika 5.a e ketij ligji, Komisioni i Koncesionit/Partneritetit Publik Privat ne detyrat qe kryen ky komision:

a) harton studimin e fizibilitetit për koncesionin /partneritetin publik privat, përcakton procedurën e zbatueshme për dhënien e koncesionit /partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit;

b) shqyrton dhe vlerëson ofertat e pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje, që janë dorëzuar; Nga deduksioni yne llogjik, referuar dhe vleres se perafert te perilogaritur nga Autoriteti Kontraktues dhe vendosur ne sistemin elektronik te APP, prej 750,000,000 Leke na rezulton nje fuqi te perafert nga 6 deri ne maksimumin prej 8 MË. Pra Anetaret e Komisionit te koncesionit si mund ta pranoje me vetedije dhe te favorizojne nje oferte te tille aspak reale qe do te çojte ne nenshkrimin e nje kontrate te deshtuar qe ne fillim te saj? Kjo oferte aspak reale dhe e “fryre” artificialisht thjesht per te fituar me shume pike ne kriteret e vleresimit do te rezultonte ne nje kontrate tjeter te deshtuar ne vazhden e atyre paraardhese, ku me duhet t’ju kujtojme se shoqeria “Advisor C Energy” shpk me te njejten llogjike ju akordua nje kontrate e cila as u realizua ndonjehere dhe as u arrit qe te shitej ndonjehere. Ne kete kuptim oferta e paraqitur nga ana jone eshte me e realizueshme dhe e bazuar ne perlllogaritje reale dhe korrekte te parametrave teknik.

f. Gjithashtu, afati i ndertimit i ofertuar prej 8 muajve eshte gjithashtu subjekt i parashikimeve te vendosura nga Autoriteti Kontraktues ne seksionin perkates, ne te cilen citohet se: “Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, (nëse është e nevojshme do te kërkojë asistencë nga konsulenti i jashtëm), do te shqyrtoje grafikun e punimeve dhe afatin e paraqitur ne oferte dhe, ne rast se konstaton se afati i deklaruar nga ofertuesi është jashtë çdo praktike te mire industriale (sipas normave

mesatare shqiptare dhe ndërkombëtare te realizimit te një vepre te tille energjetike), atëherë do te vendose qe ofertuesi per këtë kriter te mos marre asnje pike ”. Tashme qe Autoriteti Kontraktues ka nje pervoje te gjate per dhenien me koncesion te hidrocentraleve eshte e habitshme qe ka kualifikuar nje oferte te tille, pasi ne asnje praktike e mire industriale nuk rezulton ndertimi i nje vepre hidroteknike te permasave te tilla te ofruar per nje periudhe 8 mujore.

2. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Alko-Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj dhe “Rej” sh.p.k., rezulton te mos kete permbushur keto kerkesa te Dokumentave te Koncesionit:

a. Kontrata e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive i referohet nje Autoriteti tjetër Kontraktues qe nuk ka te beje me Ministrine e Infrastruktures dhe Energjise. Ne kete sens, gjykojme se e gjithë oferta e paraqitur nuk mund te shqyrtohet dhe me pas vleresohet nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise qe praktikisht eshte Autoriteti kontraktues per dhenien me Koncesion te hidrocentralit Veleshice.

b. Ne dokumentat e koncesionit, ne seksionin e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive eshte cilesuar paraqitja e statutit aktual per secilin nga anetaret e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive. Nderkohe qe, as shoqeria “Alko-Impex General Construction” degë e shoqërisë se huaj dhe as shoqeria “Rej” sh.p.k. nuk kane dorezuar statutin aktual te shoqerive perkatese per te gjykuar, thone Dokumentat e Koncesionit, se cili eshte organi vendimmarres te ketyre shoqerive.

Mungesa e statutit te shoqerive perben shkak skualifikimi ne baze te pikes 2.1 te Seksionit te Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive, nen kriterave ligjore te kualifikimit te Shtojces 9 te DSK.

c. Per me teper ne vijim, nuk jane paraqitur Vendimet e Asambleve te ketyre shoqerive ne perputhje me percaktimet e shtojces 21 te Dokumentave te Koncesionit. Tashme duket qarte, se ky Bashkim i Perkohshem nuk eshte krijuar ligjerisht, ne baze te rregullave te mirepercaktuara, jo vetem ne ligj por dhe ne Dokumentat e Koncesionit.

d. Ne te njejten llogjike si me oferten e paraqitur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “BE-IS” sh.p.k. dhe “EL-PROM” sh.p.k., oferta teknike e paraqitur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Alko-Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj dhe “Rej” sh.p.k nuk eshte e bazuar teknikisht pasi ky i fundit ka ofertuar ndertimin e hidrocentrale me nje fuqi te pergjithshme 8.4 MË. Eshte e pamundur pra, qe me kushtet qe kane qene te mirepercaktuara per ndertimin e ketyre veprave hidroenergjetike te rezultojte nje fuqi e vendosur prej me shume se 8 MË.

Ne keto kushte do te kerkojme dhe ekspertize te posacme me qellim sakesimin e parametrave hidroenergjetike te hidrocentralit Veleshice, qofte nga oferta e paraqitur nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “BE-IS” sh.p.k. dhe “EL-PROM” sh.p.k., por dhe nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Alko-Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj dhe “Rej” sh.p.k. Kerkesa kjo e theksuar dhe ne seksionin e dedikura me poshte te ketij formulari ankimimi.[...]”

II.5. Në datën 04.05.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 3257/11 prot., datë 02.05.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktues lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktues,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se: “[...] -Persa i perket pikes 3 3. Shoqërisë Projektuese E.B.S. sh.p.k. i mungojnë pikat e licencës profesionale 3/c; 4/b-d; 5/e; 10/a-b; Ju bejme me dije se per hartimin e projektit te ketij koncesioni ka patur nje pjesemarrje te dy kompanive projektuese “E.B.S” sh.p.k dhe “TAULANT” sh.p.k te cilat jane marre me pjese te ndryshme te hartimit te projektit te nevojshem per projektin e kerkuar. Pikat e paraqitura si mungese te licenses profesionale nga ana e “E.B.S” sh.p.k plotesohen nga ana e shoqerise tjeter projektuese “Taulant” sh.p.k pikat 3/c; 4/b; 10/a-b i permbush te gjitha shoqeria tjeter projektuese pra “Taulant” sh.p.k. Persa i perket pikes se licenses 4/d e cila parashikon Projektim te sistemeve komplekse te telekomunikacioni, e shohim te paarsyshme ne nje procedure si kjo e jona koncesion per ndertimin e HEC Veleshica[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e koncensionit, Shtojca 9. “Studimin e fizibilitetit të HEC-it (-ve)” në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, nga autoriteti kontraktues është kërkuar:

“Studimi i Fizibilitetit të HEC-it është kompleksi i studimeve ose raporteve të nevojshëm për të realizuar ndërtimin e hidrocentraleve, të cilët shndërrojnë energjinë e ujit në energji elektrike. Për një shfrytëzim optimal të potencialit ujqor të rrjedhjes dhe që jep ndikimin më pozitiv në mjedisin ekonomik, social dhe ekologjik të rajonit - studimi i fizibilitetit duhet të përmbajjë raporte të detajuara, në nivel projekt ideje si më poshtë:

- 1. Studimin Hidrologjik;*
- 2. Raportin Gjeologo-Inxhinierik;*
- 3. Raportin Hidroteknik dhe hidroenergjetik;*
- 4. Studimin për skemën elektrike të centralit dhe lidhjes me sistemin energjetik;*
- 5. Analiza ekonomike dhe financiare;*
- 6. Grafiku i Punimeve;*
- 7. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisin ekologjik dhe social;*
- 8. Oponenca e Studimit të Fizibilitetit bëhet nga studio të specializuara dhe licensuara për këtë qëllim;*

Oponenca e Studimit te Fizibilitetit të bëhet e plotë për të gjithë elementet e projektit dhe te raporteve të paraqitura me sipër. Oponenca të shprehet në mënyrë të detajuar dhe të japë një mendim të plotë dhe me përgjegjësi profesionale.

Shënim:

1. Propozimi per ndërtimin me koncension të hidrocentralit/eve duhet të projektohet nga studio të licensuara për këtë qëllim dhe të regjistruara ne Qendrën Kombëtare të Biznesit, ky është një kusht skualifikues.

2. Studio projektimi, e licensuara per këtë qellim, me pikat si më poshtë:

- Kategoria 3 gerrat a), b), c)
- Kategoria 4 gerrat a), b), c), d)
- Kategoria 5 gerrat a), b), c), d), e), f)
- Kategoria 8 gerrat a),
- Kategoria 9 a), b), c), d), e)
- Kategoria 10 a), b), c), d), e)

Dhe e pajisur me certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2004, 18001:2007, 39000:2012”.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e dhënies së Koncesionit, nga BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k ka dorëzuar:

1. Harta e pellgut ujëmbledhës të HEC “Veleshica 1” dhe “Veleshica2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
2. Studim Hidrologjik për ndërtimin e HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
3. Harta e gjeologjike e zonës dhe planvendosja e HEC “Veleshica 1” dhe “Veleshica2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
4. Raporti gjeologo-inxhinierik për ndërtimin e HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k
5. Profili gjatësor i lumit Veleshica, shpërndarja e prurjeve, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
6. Raporti hidroteknik dhe hidroenergjitik për ndërtimin e HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
7. Tabela përmbledhëse e llogaritjes së fuqisë dhe energjisë teorike për pellgun e lumit Veleshica, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
8. Raporti elektrik për ndërtimin e HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k
9. Profili gjatësor i skemës hidroenergjitike të lumit Veleshica, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k
10. Grafiku i punimeve në HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
11. Profili gjatësor i HEC “Veleshica 2”, parametrat hidrologjik, hidroteknik, topografik, gjeologjik, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k
12. Planvendosja e veprave të marrjes dhe dekantuesit, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.

13. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedisin ekologjik dhe social për ndërtimin e HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k dhe shoqëria projektuese “Taulant” sh.p.k.
14. Oponenca teknike për ndërtimin e HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “Sphaera” sh.p.k
15. Planimetira e basenit të presionit për HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
16. Planvendosja e godinë së HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
17. Analiza ekonomiko-financiare për ndërtimin e HEC “Veleshica 1”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
18. Planvendosja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës për HEC “Veleshica 1” dhe HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
19. Studim Hidrologjik për ndërtimin e HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
20. Harta gjeologjike e zonës dhe planvendosja e HEC “Veleshica 1” dhe HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
21. Raporti gjeologo-inxhinierik për ndërtimin e HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k
22. Raporti hidroteknik dhe hidroenergjitik për ndërtimin e HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k
23. Raporti elektrik për ndërtimin e HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k
24. Analiza ekonomiko-financiare për ndërtimin e HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
25. Grafiku i punimeve në HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.
26. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedisin ekologjik dhe social për ndërtimin e HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k dhe shoqëria projektuese “Taulant” sh.p.k.
27. Oponenca teknike për ndërtimin e HEC “Veleshica 2”, e kryer nga Shoqëria projektuese “Sphaera” sh.p.k
28. Ekstrakt i thjeshtë dhe Ekstarkt Historik i Shoqërisë projektuese “E.B.S” sh.p.k.
29. ISO-t përkatëse të Shoqërisë projektuese “E.B.S” sh.p.k.
30. Licence nr.5610/5, lëshuar nga MIE, për Shoqërinë projektuese “E.B.S” sh.p.k
31. Ekstrakt i thjeshtë dhe Ekstarkt Historik i Shoqërisë projektuese “Taulant” sh.p.k.
32. ISO-t përkatëse të Shoqërisë projektuese “Taulant” sh.p.k.

III.1.3.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur,

gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës koncesionare. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktues është e rëndësishme të provohet që shoqëritë projektuese që kanë kryer studimet e fisibilitetit zotërojnë licencimin nga MIE sipas kategorive të kërkuara në dokumentat standarte të koncensionit.

III.1.4.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k në përmbushje të kriterit për kualifikim të sipërcituar, administruar nëpërmjet autoritetit kontraktues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se pothuajse të gjithë studimet e fisibilitetit, planvendosjet, grafikët e punimeve dhe analizat janë kryer vetëm nga shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k., me përjashtim vetëm të raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedisin ekologjik dhe social për ndërtimin e HEC-ve “Veleshica 1” dhe “Veleshica 2”, të cilët janë kryer në bashkëpunim edhe me shoqërinë projektuese “Taulant” sh.p.k..

III.1.5.Nga shqyrtimi i licencës të paraqitur nr.5610/5, lëshuar nga MIE, për Shoqërinë projektuese “E.B.S” sh.p.k, rezulton se kjo e fundit nuk është e licencuar për kryerjen e projekteve në kategoritë 3-c; 4-b; 4-d; 5-e;10-a dhe 10-b, sipas kërkesave të autoritetit kontraktues në dokumentat standarte të koncensionit, të procedurës konkurruese objekt ankimi. Komisioni, gjykon se për kryerjen studimeve dhe projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve, VKM nr.759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar, përcakton se shoqëritë projektuese duhet të jenë të licencuara në kategorinë 10-a: “10. Projektimi i impiantëve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike a) Centrale hidraulike (elektrike, primare, sekondare). Kjo kategori jepet vetëm për persona juridik (shoqëri/studio).”. Pretendimi i BOE ankimues se ky kriter plotësohet pasi këto kategori licence posedohen nga shoqëria projektuese “Taulant” sh.p.k. nuk qëndron, pasi ky i fundit ka marrë pjesë vetëm në hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedisin ekologjik dhe social. KPP gjykon se, për hartimin e studimeve dhe projekteve, shoqëritë projektuese duhet të jenë të licencuara sipas kategorisë përkatëse për secilin lloj studimi/projektimi, dhe në rastin konkret, detyrimin për të disponuar licencimin në kategoritë 3-c; 4-b; 4-d; 5-e;10-a dhe 10-b e ka shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria projektuese “E.B.S” sh.p.k., nuk posedon licencimet në kategoritë e kërkuara nga autoriteti kontraktues, për kryerjen e studimeve të fisibilitetit për objektin e kontratës koncesionare, e për rrjedhojë BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k ndodhet në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vecantë të vendosur nga autoriteti kontraktues në shtojcën 9 të dokumentave të koncensionit.

III.1.6.K.P.P. gjykon se në rast se BOE ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kerkesën e mësipërme të autoritetit kontraktues, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës konkurruese objekt ankimi, parashikuar nga neni 43 pika 2 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, ku parashikohet se “2. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës konkurruese, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.”.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e konkurrimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi BOE ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative.

III.3. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Alko – Impex General Construction” d.sh.h. & “Rej” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtij bashkimi operatorësh ekonomik është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 09.03.2018, ku rezulton i skualifikuar nga kjo procedurë konkurrimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Nga ana tjetër, nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që ky bashkim operatorësh ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë konkurrimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i mbi BOE “Alko – Impex General Construction” d.sh.h. & “Rej” sh.p.k. nuk do të merret në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. për të skualifikuar e ofertën e BOE “Be - Is” sh.p.k. & “El - Prom” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e BOE ankimues pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, ky i fundit nuk gëzon më interes të ligjshëm në përputhje me pikën 1 të nenit 43 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, pasi pozitat e këtij bashkimi operatorësh ekonomik në këtë procedurë konkurrimi nuk do të ndryshonin.

III.4.1.Neni 43, pika 1, i ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, parashikon se: *“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë konkurruese dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor të koncesionit/partneritetit publik privat, për të cilin pretendon se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtë të ankimojë në Komisionin e Prokurimit Publik.”*

III.4.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktues. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 43, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktues. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e konkurruese, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e konkurruese, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë konkurruese. Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Ndregjoni” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. & Liqeni VII” sh.a. & “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Gjelbërimi 2000” sh.p.k. për procedurën konkurruese “E hapur”, me objekt: “Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Veleshicë”, me nr. REF-43477-02-02-2018, me fond limit 750.000.000 lekë, zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
2. Autoriteti kontraktues lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës konkurruese të sipërcituar.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 792 Protokoli, Datë 20.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Zv/Kryetar
Leonard Gremshi**

**Anëtar
Hektor Balluku**

**Anëtar
Kleves Janku**

**Kryetar
Evis Shurdha**